



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 199, Datë 03.08.2022

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “NRG POWER” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 13 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.08.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1379/9 prot., datë 29.07.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 169, datë 28.06.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 29.06.2022 dhe 30.06.2022) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.07.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 674/3 prot., datë 07.07.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimmarrjen e mësipërme dhe për dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 674/4 prot., datë 18.07.2022 dhe nr. 673/6 prot., datë 28.07.2022.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar.
- Në zbatim të përcaktimeve të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*, e ndryshuar, për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: Formatin dhe dokumentacionin për aplikim; Dokumentacionin juridik dhe administrativ; Dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe Dokumentacionin teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë gjithë dokumentacionin e kërkuar.
- Shoqëria ka depozituar në ERE informacion mbi sistemin IT që do të instalojë për qëllime të ushtrimit të veprimtarisë, ndaj me fillimin e operimit, ajo të dokumentojë në ERE instalimin e këtij sistemi.
- Kontrata e qirasë e depozituar nga shoqëria në kuadër të dokumentacionit që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t'i ofrohen klientëve, është e vlefshme deri më 31.12.2024 dhe nuk mbulon të gjithë periudhën e licencimit, ndaj shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar, jo më vonë se data e fundit e afatit të vlefshmërisë së saj, pra brenda datës 31.12.2024.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “NRG Power” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.
2. Me fillimin e operimit, shoqëria “NRG Power” sh.p.k. duhet të dokumentojë në ERE instalimin e sistemit IT.
3. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE kontratën e rinovuar të qirasë jo më vonë se data e fundit e afatit të vlefshmërisë së saj (brenda datës 31.12.2024).
4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI